



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS

BULETINI VJETOR I SËMUNDJEVE NGJITËSE

01 Janar - 31 Dhjetor, 2024

PËRMBAJTJA E BULETINIT

1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse gjatë periudhës janar - dhjetor 2023 dhe 2024
2. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave (të dhenat e agreguara), sipas komunave dhe grup-moshës
3. Sëmundjet e raportuara në Kosovë, sipas komunave (individuale)
4. HIV/AIDS dhe Infeksionet seksualisht të transmetueshme
5. Vaksinimi në Kosovë
6. COVID-19 gjatë vitit 2024
7. Rastet e vdekjeve nga sëmundjet ngjitëse
8. Epidemitë familjare dhe kolektive gjatë vitit 2024
9. Rekomandimet

Qëllimi i buletinit është:

Që të përcillet dhe vlerësohet situata epidemiologjike me sëmundje ngjitëse në Kosovë, trendin e sëmundjeve ngjitëse, momentet me valide epidemiologjike, shkallën dhe kualitetin e raportimit të institucioneve shëndetësore me qëllim të përf forcimit të parandalimit, kontrollës dhe përgjigjes epidemiologjike.

1. Numri i rasteve dhe vdekjeve nga sëmundjet ngjitëse, janar – dhjetor 2023 dhe 2024

Gjatë periudhës janar – dhjetor 2024 gjithsej janë raportuar **277,412 raste** të sëmundjeve ngjitëse me **Inc. 15,566.45/100,000** banorë. (Tab.1 dhe Aneksi.1).

Ky numër i sëmundjeve ngjitëse është dukshëm më i lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023, me 246,339 raste të raportuara ose Inc. 13,822.85/100,000 banorë). Gjithashtu gjatë vitit 2024 janë raportuar 119 raste të vdekjeve nga sëmundjet ngjitëse që janë një element shqetësues dhe kërkojnë vëmendje për përmirësimin e

masave të parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve ngjitëse. (Tab.1 dhe Tab.12)

Këto të dhëna tregojnë një tendencë të përgjithshme në rritje të disa sëmundjeve ngjitëse në Kosovë, veçanërisht ato që lidhen me infeksionet respiratore, ato që përhapen përmes ujit dhe ushqimit, si dhe disa sëmundjeve zoonotike dhe disa prej sëmundjeve vaksinëpreventabile (Pertussis), të cilat këtë vit kanë shënuar rritje.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, në Kosovë numër i konsiderueshëm i sëmundjeve ngjitëse janë raportuar në numër më të lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Numër më i lartë i rasteve të raportuara shihet te sëmundjet e formës së agreguar si: pneumonitë, Influenca sezonale, dhe diaretë akute (Tabela 1 dhe 2, Grafikoni 1). Mbikëqyrja me COVID-19 është realizuar në baza javore ku është përgatitur analiza javore e situatës epidemiologjike me COVID-19 duke bërë krahasimin me periudhën e mëparshme, janë përditësuar projeksionet për dy javët e ardhshme, të dhënat e mbikëqyrjes virologjike dhe të dhënat e përfshirjes me vaksinën kundër COVID-19.

Gjithashtu janë raportuar numër i konsiderueshëm i infeksioneve gastrointestinale, që përhapen përmes konsumimit të ushqimit dhe ujit si dhe nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me individë të infektuar. Rritja e këtyre infeksioneve tregon nevojën për përmirësimin e masave të sigurisë ushqimore si dhe edukimit për higjienën personale dhe ruajtjen e kushteve të shëndetshme në ambiente publike dhe private.

Zoonozat në Kosovë, veçanërisht Brucelloza humane dhe Tularemia, kanë treguar një tendencë në rritje të numrit të rasteve të raportuara, me një rritje të dukshme të rasteve të Brucellozës krahasuar me vitin 2023. Kjo sugjeron mundësinë e një shpërthimi të ri të kësaj sëmundjeje, që kërkon vëmendje të shtuar për masat parandaluese dhe fuqizim të bashkëpunimit sipas qasjes "Një shëndet".

Në raport me sëmundjet transmise, West Nile Virus (WNV), ka shënuar rritje krahasuar me periudhën paraprake, situatë kjo epidemiologjike e cila ka korresponduar me vendet e rajonit, është raportuar numër i njëjtë i rasteve të etheve hemorragjike me sindromë veshkore, paraqitje një rasti me EHKK si dhe rastit të parë të importuar me Mpox.

Sëmundjet vaksinëpreventabile (Parotiti epidemik, Pertussis, Fruthi), parotiti raportohet në numër të njëjte krahasuar me periudhën paraprake dhe këtë vit janë raportuar, rritje me Pertussis dhe një rast i importuar me Fruth.

Rastet me IST këtë vit tregojnë tendencë në rënie të numrit të rasteve të raportuara përderisa HIV/AIDS raportohet me numër më të lartë se gjatë vitit 2023.

NUMRI I RASTEVE DHE INCIDENCA E SËMUNDJEVE NGJITËSE NË KOSOVË, JANAR - DHJETOR TË VITIT 2023 DHE 2024

Tabela 1. Rastet/Incidenca e sëmundjeve ngjitëse 2023 dhe 2024

Numri i rasteve dhe Incidenca e sëmundjeve ngjitëse janar - dhjetor të vitit 2023 dhe 2024				
Sëmundjet/shkaktarët	janar-dhjetor, 2023		janar-dhjetor, 2024	
	Nr.	Incidenca / 100,000	Nr.	Incidenca / 100,000
COVID-19	2153	120.81	1735	97.36
ITPR - Pneumonia/ARI	16950	951.12	17646	990.17
SARI (forma e rëndë e pneumonisë)	262	14.70	207	11.62
Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI)	129315	7256.27	138825	7789.90
Influenca A	235	13.19	297	16.67
Influenca AH1N1	47	2.64		0.00
Influenca A H3	1	0.06	3	0.17
Influenca B	179	10.04	40	2.24
Influenca B/Victoria	29	1.63	1	0.06
RSV	68	3.82	177	9.93
Human Adenovirus	4	0.22		0.00
Diarea acute	82884	4650.88	108077	6064.54
Variçela	10999	617.19	6536	366.76
Sindromi meningjeal	232	13.02	155	8.70
EHSV	2	0.11	2	0.11
EHHK	0	0.00	1	0.06
Campilobacter	1	0.06		0.00
Helmimet me ushqim	936	52.52	1102	61.84
Rota virus	73	4.10	93	5.22
Salmonella enteritidis	76	4.26	46	2.58
Shigelloza	2	0.11		0.00
Adenovirus		0.00	21	1.18
Enterovirus		0.00	16	0.90
Norovirus			3	0.17
Gastroenterokolitet	398	22.33	764	42.87
Hepatiti akut A	3		2	0.11
Hepatiti akut B	37	2.08	40	2.24
Hepatiti akut C	4	0.22	3	0.17
E.coli patogjene	2	0.11	4	0.22
Parotiti epidemik	30	1.68	32	1.80
Morbilli**	1	0.06	1	0.06
Pertussis	2	0.11	209	11.73
Tularemia	4	0.22	10	0.56
Brucellosis	33	1.85	55	3.09
Leishmaniazë	7	0.39	1	0.06
Leptospirosis	5	0.28	3	0.17
Toxoplazmozis	8	0.45	6	0.34
WNV	1	0.06	7	0.39
Malarie**	3	0.17	4	0.22
Sëmundja Lyme	12	0.67	8	0.45
TB	585	32.83	466	26.15
HIV/AIDS	20	1.12	34	1.91
IST	480	26.93	400	22.45
Echinococcus	2	0.11	5	0.28
Mpox**			1	0.06
Parazitoza	20	1.12		0.00
Askariaza	7	0.39		
Giardiaza	46	2.58	30	1.68
Entameba Hystolitica	1	0.06	2	
Clostridium difficile	2	0.11		0.00
Infeksionet streptokoksike të grupit A			119	6.68
*Sëmundjet tjera ngjitëse	178	9.99	223	12.51
Gjithsej	246339	13822.85	277412	15566.45
*Sëmundjet tjera ngjitëse: Herpes zoster, Mykozat, Mononucleoza				
**Raste të importuara				

2. Sëmundjet ngjitëse të raportuara gjatë vitit 2024, sipas komunave dhe grup-moshës

(Të dhënat e agreguara)

Në periudhën janar-dhjetor 2024, grupi i sëmundjeve me të dhëna të agreguara ka shënuar një numër total prej 271,084 raste, duke paraqitur një rritje prej 12.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Përsa i përket shpërndarjes së rasteve, Influenca sezonale/ILI raportohet me numrin më të lartë të rasteve, me 138,825 raste, apo 7,789.90 raste për 100,000 banorë. Kjo është një përqindje e konsiderueshme e rasteve të raportuara me përfaqësim prej (52%) nga ky grup i sëmundjeve.

Po ashtu, Diarrea akute është një tjetër sëmundje dominuese, me 108,077 raste të raportuara, ose 6,064.54 raste për 100,000 banorë, që përbën 41% të rasteve të raportuara nga ky grup sëmundjesh.

Për Pneumonitë dhe Infeksionet e Rrugëve të Poshtme të Frymëmarrjes (ARI) janë raportuar 17,646 raste, ose 990.17 raste për 100,000 banorë. Ky numër është lehtësisht më i lartë krahasuar me vitin 2023, ku ishin raportuar 16,950 raste, apo 951.12 raste për 100,000 banorë.

Nga ana tjetër, Variçella ka treguar një ulje të ndjeshme të numrit të rasteve të raportuara, me 6,536 raste ose 366.76 raste për 100,000 banorë. Kjo përbën një ulje prej 40.6% krahasuar me vitin 2023, kur ishin regjistruar 10,999 raste.


Në përgjithësi, këto të dhëna sugjerojnë një ngarkesë të lartë shëndetësore, veçanërisht për sëmundjet ngjitëse të traktit respiratorë dhe gastrointestinal, ndërkohë që variçella ka treguar një rënie të dukshme. Rastet e raportuara nga trakti respiratorë kryesisht regjistrohen në tremujorin e parë të vitit dhe nga muaji gusht, shtator (periudha kur kemi pasë pikun nga COVID-19) për të vazhduar me muajin tetor kur edhe fillon intensifikimi i aktiviteteve gjatë sezonës së gripit dhe mbikëqyrjes më intenzive nga Institucionet shëndetësore.

Numri i lartë i rasteve të raportuara me Diare akute mbetet shqetësim për shëndetin publik, pasojë kjo e ekspozimit ndaj patogjenëve të ndryshëm në ushqim dhe ujë, ndërprerjet e ujit dhe kycjet ilegale në ujësjellës, mungesa e kanalizimit, dispozicioni i mbeturinave jo i rregullt, kushtet e dobëta ekonomike dhe higjienike të cilat në Kosovë janë ende evidente. (Tab.1 dhe 2).

Tabela 2. Rastet e sëmundjeve ngjitëse (të dhënat e agreguara) në Kosovë, 2024

SËMUNDJA KOMUNA	<i>Pneumoni a/ARI</i>	<i>ILI</i>	<i>Diarrhea ac</i>	<i>Variçella</i>	<i>Totali</i>
DEÇAN	45	1289	1763	36	3133
DRAGASH	216	1155	2182	41	3594
DRENAS	576	1866	914	136	3492
F. KOSOVË	540	4682	3362	365	8949
FERIZAJ	357	6119	5668	200	12344
GJAKOVË	235	1898	1793	108	4034
GJILAN	340	7857	6379	321	14897
GRAÇANICË					0
H. I ELEZIT	190	860	445	13	1508
ISTOG	127	2481	1287	72	3967
JUNIK		687	686	6	1379
KAÇANIK	27	1261	1068	62	2418
KAMENICË	11	4896	2659	48	7614
KLINË	266	1170	1516	131	3083
KLLOKOT					0
LEPOSAVIQ					0
LIPJAN	102	1488	1313	245	3148
MALISHEVË	207	1898	2411	355	4871
MAMUSHË					0
MITROVICË	568	7610	7512	393	16083
MITROVICË E VERIUT					0
N. BËRDË		315	173	30	518
OBILIQ	256	2188	2821	148	5413
PARTESH					0
PEJË	171	9580	8387	423	18561
PODUJEVË	300	10210	4118	406	15034
PRISHTINË	11132	43299	27459	1385	83275
PRIZREN	700	10677	11175	764	23316
RAHOVEC	252	720	924	136	2032
RANILLUG					0
SHTËRPCE					0
SHTIME	166	1469	632	56	2323
SKËNDERAJ	20	1758	2095	105	3978
SUHAREKË	314	6735	4190	207	11446
VITI	46	3433	2591	90	6160
VUSHTRRI	482	1224	2554	254	4514
Z. POTOK					0
ZVEÇAN					0
TOTALI	17646	138825	108077	6536	271084


Grafikoni 1. Rastet e sëmundjeve ngjitëse 2024, të dhënat e agreguara të shprehura në përqindje



Me përcjellje të rregullt të situatës epidemiologjike me Sëmundje e ngjashme me gripin (ILI) është vërejtur se Intensiteti i Influcencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara gjatë sezonës 2024 u paraqit në aktivitetin e lartë të qarkullimit dhe sezona 2024/2025 tregon tendencë të njejtë krahasuar me sezonën paraprake. (Graf.2).


Grafikoni 2. Ecuria e Influcencës sezonale (ILI) në Kosovë, sezona 2020/2021-2024/2025

Ecuria e Influcencës sezonale (ILI) në Kosovë, sezonat 2020/2021 - 2024/2025




Numri më i lartë i rasteve raportohet nga: komuna e Prishtinës (43,299 raste), Prizrenit dhe Podujevës me (10,677 respektivisht 10,210 raste) derisa numër me të ulët të rasteve raportojnë komunat: Novobërdë me (315 raste) dhe Junik (687 raste) kurse sipas Incidencës, numër më të lartë kanë komunat: Prishtinë, Kmenicë dhe Fushë Kosovë. (Tab.2 dhe Graf. 3)

Grafikoni 3. Rastet ILI sipas komunave dhe Incidenca në Kosovë, janar-dhjetor 2024




Rastet e raportuara nga trakti respiratorë (ILI) kryesisht regjistrohen në tremujorin e parë të vitit dhe nga muaji gusht-shtator (periudha kur kemi pasë pikun nga COVID-19) për të vazhduar me muajin tetor kur edhe fillon intensifikimi i aktiviteteve gjatë sezonës së gripit dhe mbikëqyrjes më intensive nga Institucionet shëndetësore. (Graf.4)

Grafikoni 4. Numri i rasteve me /ILI dhe Incidenca/100,000 banorë sipas muajve, Kosovë 2024



Në grupin e sëmundjeve që raportohen me të dhëna të agreguara sipas grup-moshës (Graf. 5), më e atakuar, është grup-mosha 5-49 vjeç për: influencë sezonale, diare akute dhe varicellë kurse numri më i ulët i rasteve për ILI dhe varicellë raportohet nga grup-mosha 0-4 vjeç për dallim nga pneumonitë dhe diaretë akute, ku numri më i ulët i rasteve raportohet nga grup-mosha mbi 50 vjeç.


Grafikoni 5. Rastet e sëmundjeve ngjitëse në Kosovë, 2024, sipas grup-moshës (të dhënat e agreguara)



3. Sëmundjet ngjitëse të raportuara në Kosovë, 2024 sipas komunave (Të dhënat individuale)

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, nga grupi i sëmundjeve ngjitëse të cilat raportohen në formën individuale janë regjistruar gjithsej 6,328 raste ose 355.08/100,000 banorë. Kjo tregon një rritje prej 12.86% krahasuar me vitin 2023, ku ishin regjistruar 5,606 raste ose 314.57 raste për 100,000 banorë, situatë kjo epidemiologjike që mund të lidhet me disa faktorë, duke përfshirë mundësinë e rritjes së raportimeve për disa sëmundje apo edhe konfirmimin laboratorik të tyre. Në raport me përqindjen e rasteve të regjistruara në numër më të lartë janë raportuar raste me COVID-19 me 1,735 raste (34%), Helmimet me ushqim me 1,102 raste (22%), TB me 466 (9%) pasuar me IST me 400 raste (8%) dhe sëmundjet tjera të paraqitura në (Tab.3, Graf.6).

Grafikoni 6. Rastet e sëmundjeve ngjitëse, 2024 të dhënat individuale të shprehura në përqindje




Nga ky numër, sipas komunave vërehet se numri më i lartë raportohet nga: komuna e Prishtinës (2,549 raste), komuna e Prizrenit (854 raste) dhe komuna e Mitrovicës (527 raste).

Numër me të ulët të rasteve raportojnë komuna e Graçanicës (2 raste) dhe Junikut me (1 rast). (Tab.3).

Sëmundjet respiratore dhe Tuberkulozi në Kosovë, 2024


Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influençës – IKSHPK gjatë periudhës janar- dhjetor 2024, janë testuar gjithsej 3,812 mostra nga qendrat sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga 3,812 mostrat e testuara në Influençë dhe patogjenët tjerë respiratorë janë konfirmuar 341 raste me Influençë A dhe B (pozitiviteti 8.94 %). Sipas tipit: me Influençë A (300 raste apo 7.86%) dhe Influençë B (41 raste apo 1.07%). Sipas komunave: Prishtinë (201 raste), Pejë (20 raste), Fushë Kosovë (19 raste), Podujevë (15 raste), Vushtrri (12 raste), Ferizaj (10 raste), Prizren (8 raste), Drenas (7 raste), Istog (7 raste), Malishevë (7 raste), Mitrovicë (7 raste), Lipjan (5 raste), Obiliq (4 raste), Deçan (3 raste), Kaçanik (3 raste), Skenderaj (3 raste), Gjakovë (2 raste), Gjilan (2 raste), Rahovec (2 raste), Viti (2 raste) dhe me nga një rast komunat: Shtime dhe Klinë. Nga mostrat pozitive me Influençë A dhe B, shohim se grup-mosha më e atakuar është ajo 0-4 me (114 raste), 5-14 vjeç me (63 raste), 65+ me (58 raste) dhe për të vazhduar me grup-moshat tjera si: 35-50 vjeç me (38 raste), 51-64 vjeç me (37 raste) dhe 15-34 vjeç me (31 raste). Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 218 mostra me Human Rhinovirus apo (5.71%), 188 mostra me Human Adenovirus apo (4.93%), 177 mostra me Virusin Sintical (RSV) apo 4.64%, 32 mostra me Parainfluenca Virus (0.83%) dhe 16 mostra me Human Metapneumovirus (0.41%). (Graf. 7).

Grafikoni 7. Mbikëqyrja virologjike me Influençën A, B, (RSV) dhe patogjenët tjerë respiratorë sipas muajve, Kosovë 2024



Sipas subtipit: me Influcencë A të pasubtipizuar janë 297 raste (87%), me subtipin AH3 janë 3 raste (1%), me subtipin Influcencë B Victoria 1 rast (0 %) dhe Influcencë B të pasubtipizur janë 40 raste (12%). (Graf.8).

Grafikoni 8. Influenca A dhe B sipas sub-tipit në Kosovë, janar-dhjetor 2024



Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, nga 341 rastet pozitive në Influcencë A dhe B, 100 prej tyre ishin hospitalizuar në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatriisë dhe spitalet rajonale. Vërejmë se rastet me infeksione akute respiratore karakterizohen me një numër më të lartë të pacientëve të hospitalizuar (1,494 raste) pasuar nga rastet me infeksione akute të rënda respiratore me (207 raste), sëmundjen e ngjajshme me gripin (104 raste), Influcencë A (88 raste) dhe Influcencë B (12 raste).

Gjatë vitit 2024, në total u raportuan 207 raste SARI, të hospitalizuara në qendrat sentinel të Kosovës. Të gjitha rastet, sipas protokolit dhe kërkesave të klinikistit, u testuan së paku në tre viruse respiratore, SARS-CoV-2, Influenza dhe RSV. Që nga viti 2022, Kosova është duke kryer një hulumtim për efektivitetin e vaksinave kundër COVID-19, që funksionon si mbikëqyrje sentinel e rasteve SARI.

Nga 207 raste SARI të cilët ishin raportuar gjatë vitit 2024, ne i kemi listuar ata sipas statusit të tyre vaksinal. Prej tyre, 22 (10.62%) ishin të pavaksinuar kundër COVID-19, 5 (2.41%) ishin të vaksinuar me së paku një dozë të vaksinës kundër COVID-19, 78 (37.68%) kishin së paku dy doza, 92 (44.44%) kishin së paku tri doza dhe vetëm 10 (4.83%) kishin katër doza të vaksinë kundër COVID-19. Sa i përket statusit vaksinal kundër Influenza, 84 nga pacientët ishin të vaksinuar apo 4.57%.

Më poshtë po paraqesim disa nga të dhënat e rasteve SARI, të hospitalizuar gjatë vitit 2024, në qendrat sentinel.

Tabela 4. Të dhënat sipas grup-moshës së pacientëve SARI të hospitalizuar gjatë vitit 2024, Kosovë

Grup-mosha	Numri i rasteve	%	Mosha mesatare
18-29 vjeç	23	11.11%	
30-39 vjeç	20	9.82%	
40-49 vjeç	19	9.31%	57.21 ± 21.4 vjeç
50-59 vjeç	28	13.82%	95% CI (18-91 vjeç)
60-69 vjeç	44	21.45%	
70+ vjeç	73	34.50%	
Gjinia	Femër	96	54.96%
	Mashkull	111	45.04%

Sipas, shihet se grup-mosha me më së shumti raste është ajo 70+ vjeç (34.50%) kurse ajo me më së paku raste është grup-mosha 40-49 vjeç (9.32%). Mosha mesatare, me devijim standard dhe interval të besueshmërisë 95% e pacientëve SARI ishte 57.21 ± 21.4 vjeç, 95% CI (18-91 vjeç). Te grupmoshat tjera, shpërndarja e rasteve ndjek një homogjenitet distributiv, e paraqitur edhe në tabelën 1. Sipas gjinisë, mbizotron gjinia mashkullore me 54.96% të rasteve SARI. Klinika Infektive, mbetet qendra me më së shumti pranime dhe hospitalizime, nga të gjitha qendrat sentinel në Kosovë, me 91.23% të rasteve SARI. Klinika Infektive, gjithashtu ka numrin më të madh të ditëve të mjekimit dhe kohëzgjatjen mesatare të rasteve SARI, gjatë vitit 2024.

Nga të gjithë rastet SARI të hospitalizuara në qendrat sentinel gjatë vitit 2024, ne kemi testuar dhe izoluar shkaktarët viral të mostrave nazofaringeale të sjellura në Laboratorik e Mikrobiologjisë, IKShPK. Nga 207 raste SARI, 52 kanë rezultuar pozitiv në SARS-CoV-2 (pozitiviteti 30.92%), 39 kanë rezultuar pozitiv në Influenza (pozitiviteti 13.74%), 1 ka rezultuar pozitiv në RSV (pozitiviteti 2.29%).

Gjatë vitit 2024 janë raportuar 466 raste me Tuberkuloz apo 26,15 në 100,000 banorë. Sipas komunave: Prishtina (177 raste), Ferizaj (76 raste), Prizreni (59 raste), Mitrovica (52 raste), Peja (51 raste), Gjakova (29 raste) dhe Gjiłani (22 raste). Prej 466 rasteve të raportuara, 346 (74.24%) raste pulmonare dhe 120 (25.75%) forma ektrapulmonare. Nga forma pulmonare, të konfirmuara bakteriologjikisht 164 raste (47.4%). Gjatë kësaj periudhe kohore janë raportuar 5 raste të vdekjes me TB me CFR 1.07%.

Sindroma meningjeale

Gjatë vitit 2024 janë raportuar gjithsej 155 raste me Sindromë Meningjeale (Inc. 8.69/100 000 banorë), prej tyre 101 raste me Meningjit viral, 22 raste me Meningjit purulent, 30 raste me Meningoencephalit akut dhe 2 raste me Meningoencephalit TBC. Ky numër i rasteve të raportuara paraqet ulje prej 0.3 herë apo (33%) krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2023 ku janë raportuan 232 raste. (Tab.5)


Tabela 5. Sindroma Meningjeale në Kosovë, sipas diagnozës klinike dhe komunave, janar- dhjetor, 2024

Komuna	Sepsis meningococica	Meningoencephalitis purulenta	Meningitis purulenta	Meningitis ac. serosa	Meningoencephalitis ac.	Meningitis meningococica	Meningoenceph. TBC	Total
DEÇAN			1					1
DRAGASH				1				1
FERIZAJ		1	1	9	1			12
FUSHË KOSOVË			1	7	1			9
GJAKOVË	2			3	2	1		8
GJILANI				3	1			4
DRENAS				5	2			7
ISTOG		1	1	1				3
KACANIK				1				1
KAMENICE							1	1
JUNIK								0
KLINE				2				2
LIPJAN				6	1	1		8
MITROVICË				3	3			6
NOVOBËRD								0
OBILIQ				1	1			2
PEJE				3	2	1		6
PODUJEVË				4	2			6
PRISHTINË	1	1	4	30	8			44
PRIZREN			2	4	2			8
MALISHEVË			1	4	1			6
RAHOVEC				1				1
SHTIME				1				1
SKENDERAJ				2			1	3
SUHAREKË				1	1			2
VITI			1	1				2
VUSHTRRI			1	6	2			9
ZUBIN POTOK								0
SHTERPCE								0
HANI I ELEZIT				2				2
MAMUSHE								0
Total	3	3	13	101	30	3	2	155

Hulumtimet epidemiologjik i janë nënshtruar të gjitha rastet e hospitalizuara në ShSKUK - Klinika Infektive, Klinika e Pediatriisë dhe Spitalet Rajonale.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, sipas komunave, rezulton se numri më i madh i rasteve është raportuar nga komuna e Prishtinës (44 raste), Ferizaj (13 raste), Fushë Kosovë dhe Vushtrri me nga (9 raste), Gjakova, Lipjan dhe Prizren me nga (8 raste), Drenasi (7 raste), Pejë , Mitrovicë, Drenas, Podujevë dhe Malishevë me nga (6 raste), kurse komunat tjera me numër më të ulët, ndërsa Incidenca më e lartë e rasteve në 100,000 banorë është raportuar nga komunat: Fushë Kosovë me 27/100,000 banorë, Prishtinë 22/100,000 banorë, Hani i Elezit me 21/100,000 banorë. (Graf.9)

Grafikoni 9. Numri i rasteve, Incidenca dhe vdekjet/100.000 banorë, janar- dhjetor 2024




Rastet e vdekjes nga Meningjiti në Kosovë, 2024

Gjatë këtij viti janë raportuar 18 raste të vdekjes, prej tyre 10 raste me dg. Meningoencephalitis akuta (Prishtinë dhe Prizren me nga 2 raste, kurse me nga 1 rast komunat si: Gjakovë, Mitrovicë, Malishevë, Drenas dhe Lipjan), 3 raste me dg. Meningitis ac. (prej tyre me nga 1 rast komunat: Prishtinë, Malishevë dhe Rahovec), me dg. Sepsis Meningococcicae (3 raste Gjakovë), 2 raste me dg. Meningoencephalitis ac. purulenta (1 rast Ferizaj dhe 1 rast Istog) dhe 1 rast me dg Meningoencephalitis TBC.

Ecure e sëmundjes sipas grup-moshave

Sa i përket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se numri më i madh i rasteve i takon grup- moshës 0-9 vjeç me 41.29% (64 raste), grup mosha 10-19 vjeç me 10.3% (16 raste), grup moshat 60-69 dhe 70-79 vjeç me nga 9.03 % (me nga 14 raste), grup mosha 20-29 dhe 40-49 vjeç me nga 8.38% (me nga 13 raste), kurse grup moshat tjera me numër më të ulët të rasteve. Sipas incidencës, grup mosha më e prekur është 0-9 vjeç me 24/100,000 banorë.

Grafikoni 10. Rastet dhe Incidenca specifike për grup-moshë, janar-dhjetor 2024



Ecuria e sëmundjes sipas gjinisë

Gjatë kësaj periudhe me Sindromë Meningjeale, sipas gjinisë rezulton se kemi 53.55% (83 raste) të gjinisë mashkullore dhe të gjinisë femërore 46.45% (72 raste).

Ecuria e sëmundjes sipas shkaktarit të izoluar në likuor

Diagnostifikimi i hershëm i të sëmurve nga Meningjiti ka randësi të madhe epidemiologjike, pasi ofron mundësinë e ndërmarrjes së masave të shpejta profilaktike dhe epidemiologjike. Nga mostrat humane të testuara në laboratorët e Mikrobiologjisë në IKShPK dhe laboratorin mikrobiologjik në Klinikën Infektive, janë izoluar 91 shkaktarët në Lëngun cerebrospinal (LCS) prej tyre; në 15 raste është izoluar *Streptococcus Pneumoniae*, në 11 raste është izoluar Human Enterovirus, 9 raste me Human Herpes Virus-7, në 7 raste është izoluar Epstein Bar Virusi, kurse shkaktarët e tjerë janë izoluar në numër më të ulët. (Tab.6)


Tabela 6. Shkaktari i izoluar në likuor, janar-dhjetor 2024

Shkaktari i izoluar në likuor, 2024	
Izolate	Nr.
<i>Neisseria meningitidis</i>	5
<i>Klebsiella pneumoniae</i>	
<i>Streptococcus viridans</i>	2
<i>Streptococcus pneumoniae</i>	15
<i>Streptococcus agalactiae</i>	
<i>Enterococcus faecalis</i>	3
<i>Escherichia coli</i>	1
<i>Pseudomonas</i>	
<i>Acinetobacter baumannii</i>	1
<i>Citrobacter</i>	
<i>Staph. aureus</i> dhe hemolitikus	
<i>Staphilococcus coagulaza negative</i>	
<i>Actinomyces turicensis</i>	
<i>Candida ciferri</i>	
<i>Burkholderia contaminans</i>	
<i>Proteus vulgaris</i>	
<i>Pneumokoku</i>	
<i>Hemophilus influenzae</i>	3
<i>Serratia marascens</i>	
<i>Morganella morganis</i>	
<i>Citomagalovirus</i>	2
Mumps Virus	6
Human Enterovirus	11
Human Adenovirus	1
HHV1	5
HHV6	7
HHV7	9
Human parvovirus B 19	4
Human parvovirus B 12	
HSV-1	3
HSV-2	
Varicela Zoster Virus	6
Epstein Barr Virus	7
Totali	91

Ecuria e sëmundjes krahasuar sipas muajve gjatë vitit 2023-2024

Nëse krahasojmë paraqitjen e rasteve me Sindromë Meningjeale përgjatë muajve të vitit 2024 me muajt e vitit 2023, kemi një ulje prej 52% të rasteve. Numër më i lartë i rasteve gjatë vitit 2024, është raportuar përgjatë muajit korrik me 20 raste me (Mb. 1.12/100 000 banorë) dhe muajit shtator me 17 raste me (Mb. 0.95/100.000 banorë). (Graf.11)

Grafikoni 11. Sindroma Meningjeale në Kosovë, krahasuar sipas muajve gjatë vitit 2023-2024



Zoonozat dhe sëmundjet transmise

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar gjithsej 55 raste pozitive me Brucellozë apo Incidencë 3.09/100,000 banorë, si dhe 10 raste pozitive me Tularemi apo Incidencë 0.56/ 100,000 banorë.

Rastet e konfirmuara me Brucellozë raportohen nga 13 komuna me 30 vatra. Komunitet më të prekura janë Rahoveci me 12 raste dhe Prizreni me 11 raste, Suhareka me 8 raste, Prishtina me 6 raste dhe Ferizaj me 5 raste. Komunitet tjera si: Drenasi, Lipjani, Peja dhe Fushë Kosova kanë raportuar numër më të ulët të rasteve dhe me nga 1 rast komunitet : Dragash, Malishevë dhe Podujevë. Sipas Incidencës në 100,000 banorë

komunat më të prekura janë Rahoveci (20.6 raste/100,000 banorë dhe Suhareka me 13.08 raste/100,000 banorë). Brucelloza është shfaqur kryesisht në zona të cilat janë të lidhura me aktivitete bujqësore dhe blegtorale, ku ka një mundësi më të madhe të kontaktit me kafshët, veçanërisht në komunat si Rahoveci, Prizreni dhe Suhareka. Kjo mund të shpjegohet me karakteristikat e këtyre komunave, ku shumica e popullsisë është e angazhuar në bujqësi dhe blegtori. (Tab.7 dhe Graf.12)

Tabela.7. Rastet e konfirmuara me Brucellozë në Kosovë, janar-dhjetor 2024


Rastet e konfirmuara me Brucellozë në Kosovë , janar-dhjetor 2024		
Komuna	Rastet	Vatrat
Prizren	11	Atmaxha (1), Zhuri (1), Prizren (9)
Rahovec	12	Rahovec (2), Rodostë (4), Nagavc (5), Bellacerrkë (1)
Ferizaj	5	Pleshinë (1), Komogllavë (2), Prelez (2)
Drenas	3	Komorani (2), Gllobare (1)
Dragash	1	Zlipatok (1)
Lipjan	2	Krojmin (1), Topliqan (1)
Malishevë	1	Temeqin (1)
Pejë	2	Ramun (1), Pejë (1)
Fushë Kosovë	2	Lismir (1), Fushë Kosovë (1)
Podujevë	1	Podujevë (1)
Prishtinë	6	Prishtinë (5), Prugoc (1)
Suharekë	8	Grejkoc (1), Papaz (3), Semetisht (1), Studenqan (1), Savrovë (1), Suharekë (1)
Viti	1	Viti (1)
Total	55	13 komuna me 30 vatra

Sa i përket grup-moshës, numri më i lartë i rasteve me Brucellozë është raportuar te grup-mosha 20-29 vjeç (13 raste) dhe grup-mosha 50-59 vjeç (9 raste) dhe grup-mosha 60-69 vjeç (10 raste). Sipas Incidencës specifike për grup-moshë, vërehet se grup-mosha më e prekur është 60-69 vjeç (7.15 raste/100,000 banorë), e pasuar nga grup-mosha 50-59 vjeç (4.45 raste/100,000). (Graf. 13). Sipas gjinisë, gjinia më e prekur ajo mashkullore me 32 raste (58.2%). Sa i përket shpërndarjes së numrit të rasteve sipas muajve, një numër më i lartë i rasteve është raportuar në muajt korrik (8 raste) dhe gusht (9 raste), duke treguar një rritje të ndjeshme gjatë verës. Gjithashtu qershori ka shënuar një numër të konsiderueshëm rastesh të Brucellozës me 7 raste. Gjatë muajve janar dhe shkurt është raportuar numër më i ulët i rasteve, me 3 respektivisht 4 raste. Rritja e plleshmerisë së kafshëve gjatë periudhës së verës, veçanërisht në muajt


qershor, korrik dhe gusht, ndihmon në rritjen e lindjeve dhe aktivitetit bujqësor. Temperaturat e ngrohta dhe kushte të favorshme për ushqim rrisin kontaktin e individëve me kafshët dhe produktet e tyre, duke kontribuar në shpërndarjen e Brucellozës, e cila mund të shpjegojë rritjen e numrit të rasteve të raportuara gjatë këtyre muajve. Kjo pasqyron një rritje të konsiderueshme të rasteve të Brucellozës në krahasim me vitin 2023, ku janë raportuar 9 raste me Brucellozë.

Sa i përket Tularemisë gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, janë raportuar 10 raste, ku sipas komunave: Obiliqi me numër më të lartë të rasteve të raportuara (3), përcjellur nga Gjilani me 2 raste, dhe Drenasi, Istogu, Skënderaj, Vushtrria dhe Fushë Kosova me nga një rast dhe të gjitha këto të njohura si vatra endemike për Tularemi. Sipas Incidencës në 100,000 banorë komuna më e prekur është Obiliqi me 13.6 raste /100,000 banorë dhe Fushë Kosova me 2.64 raste/100,000 banorë. Sa i përket grup-moshës, numri më i lartë i rasteve me Tularemi është raportuar te grup-mosha 20-29 vjeç (4 raste), 30-39 vjeç (3 raste), 50-59 vjeç (2 raste). Sipas Incidencës specifike për grup-moshë, vërehet se grup-mosha më e atakuar është 20-29 vjeç me 1.2 raste/100,000 banorë. (Graf.13). Sipas gjinisë: ajo femërore më e atakuar me 8 raste (80%).

Grafikoni 12. Numri rasteve me Brucellozë dhe Tularemi, Incidenca /100,000 banorë sipas komunave janar-dhjetor 2024



Grafikoni 13. Numri i rasteve me Brucellozë dhe Tularemi, Incidenca specifike për grup-moshë, janar-dhjetor 2024



Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 është raportuar një rast i konfirmuar me prani të virusit të EHKK. Rast nga fshati Konjushë-Prizren, i moshës 44 vjeç, gjinisë mashkull i cili gjatë punës në fushë është pickuar nga rriqëra dhe i cili ka përfunduar me fatalitet.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, janë raportuar dy raste me Ethe Hemorragjike me Sindromë Veshkore. Sipas gjinisë, të dy raste të gjinisë mashkullore të moshës 24 respektivisht 43 vjeç. Sipas komunave një rast nga komuna e Junikut i cili mihon qëndrimin në bjeshkë dhe rasti i dytë nga komuna e Prishtinës i cili ka qëndruar në malet e fshatit Makresh-N. Bërdë.

Me datë 26.12.2024, nga Laboratori i Mikrobiologjisë-IKShPK përmes metodës rT-PCR është raportuar një pozitiv në Mpox.

Rast i gjinisë mashkull i lindur më 1994 me vendbanim në Prishtinë. Nga hulumtimi epidemiologjik është kuptuar se rasti punon në Togo të Afrikës perëndimore dhe ka qëndruar nga data 26 gusht - 22 dhjetor 2024. Janë verifikuar të dhënat në lidhje me rastin si dhe është marrë lista e kontakteve që nga periudha e ardhjes në Kosovë. Janë gjurmuar të gjitha kontaktet e identifikuar dhe u është ofruar vaksinimi me vaksinën kundër Mpox. Bazuar në obligimet e RrNsh pas konfirmimit të rastit me Mpox në vendin tonë, rasti është raportuar në OBSH dhe bazuar në tipizim i takon clade II, e cila është endemike për Afrikën perëndimore.

Ecuria e sëmundjeve që barten përmes vektorëve për periudhën janar-dhjetor 2024

Gjatë vitit 2024 janë raportuar gjithsej 8 raste të sëmundjes së Borreliozës (Inc 0.44/100.000 banorë). Ky numër i rasteve është më i ulët për 33% krahasuar me vitin 2023 me 12 raste (Inc 0.67/100.000 banorë).

Gjatë vitit 2024 janë raportuar 4 raste të Malaries së importuar nga regjionet endemike (Inc 0.22/100.000 banorë). Ky numër i rasteve është më i lartë për 33% krahasuar me vitin 2023 me 3 raste (Inc. 0.16/100.000 banorë).

Gjatë vitit 2024 janë raportuar 7 raste të infeksionit me VNW (virusin e Nilit Perëndimor) të (Inc. 0.39/100.000 banorë). Ky numër i rasteve është dukshëm më i lartë krahasuar me vitin 2023 me 1 rast të rapaortuar (Inc. 0.06/100.000 banorë).

Vlerësimi i rrezikut:

Sëmundjet që përcillen me vektorë po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme dhe po ndryshojnë pasqyrën e ngarkesës nga sëmundjet ngjitëse. Kjo sëmundje në Kosovë është regjistruar me raste sporadike, kryesisht te pacientët e testuar me forma neuroinvazive të sëmundjes. Ndryshimet klimatike ndikojnë në shpërndarjen dhe aktivitetin e vektorëve. Ekziston një rrezik mesatar për popullatën në periudhën pranverë-verë, por ai mund të minimizohet duke iu përmbajtur rekomandimeve për parandalim që i përcjellin institucionet kompetente.

Gjatë vitit 2024 është raportuar 1 rast i Leishmaniazës (Inc. 0.05/100.000 banorë). Ky numër i rasteve është më i ulët për 85% krahasuar me vitin 2023 me 8 raste (Mb 0.45/100.000 banorë) (Tabela 8)

Tabela 8. Numri i rasteve dhe Incidenca/100,000 banorë e sëmundjeve që barten përmes vektorëve gjatë vitit 2023 dhe 2024

Sëmundja	2023		2024	
	Raste	Inc/100,000	Raste	Inc/100,000
Borrelioza	12	0.67	8	0.44
Malaria	3	0.16	4	0.22
WNV	1	0.05	7	0.39
Leishmaniaza	8	0.45	1	0.05

Rastet e borreliozës i takojnë grup moshës 0-9 vjeç dhe 40-49 vjeç (nga 1 rast), ndërkah grup moshës 20-29 vjeç, 30-39 vjeç dhe 60-69 vjeç (nga 2 raste); ndërsa gjinia më e prekur rezulton të jetë gjinia femërore me 5

raste (63%) kurse gjinia mashkullore me 3 raste (37%). Rastet e Malaries i takojnë grup moshës 20-29 vjeç dhe 40-49 vjeç (nga 1 rast) si dhe grup moshës 30-39 vjeç (2 raste) dhe 40-49 vjeç; ndërkaq 3 raste (75%) janë të gjinisë mashkullore dhe 1 rast (25%) i gjinisë femërore. Rastet e WNV i takojnë grup moshës 0-9 vjeç dhe 50-59 vjeç (nga 2 raste), 60-69 vjeç (2 raste) dhe 70-79 vjeç (1 rast), ndërsa gjinia më e prekur rezulton të jetë gjinia femërore me 4 raste (57%) dhe gjinisë mashkullore 3 raste (43%). Rasti i vetëm i Leishmaniazës është i gjinisë femërore dhe i takon grup moshës 10-19 vjeç. Sa i përket komunave rastet e Borreliozës paraqiten në komunat: Prishtinë (3 raste) ndërkaq komunat Kamenicë, Kaçanik, Malishevë, Drenas dhe Istog (me nga 1 rast).

Rastet e Malaries paraqiten në komunat: Prishtinë (2 raste) ndërkaq Ferizaj dhe Peja (me nga 1 rast). Të gjitha rastet e Malaries janë të importuara (me histori të udhëtimit në regionet endemike).

Rastet e WNV paraqiten në komunat: Fushë Kosovë (2 raste) ndërkaq komunat Prishtinë, Prizren, Lipjan, Drenas dhe Mitrovicë (nga 1 rast). Nga gjithsej 7 raste të konfirmuara me WNV, 3 raste janë të importuara (me histori të udhëtimit në vendet endemike të regjionit dhe me dëshmi të pickimit nga mushkonjat).

Ecuria e zoonozave: Toksoplazmozë dhe Leptospirozë në Kosovë për periudhën janar-dhjetor 2024

Gjatë vitit 2024 u raportuan 6 raste të toksoplazmozës (Inc 0.33/100,000). Ky numër i rasteve është më i ulët për 25% krahasuar me vitin 2023 me 8 raste (Inc 0.45/100,000 banorë). Sipas numrit në komuna rezulton se rastet janë paraqitur si në vijim: Prishtina (2 raste) ndërkaq komunat Prizren, Gjakovë, Gjilan dhe Suharekë (me nga 1 rast). Sipas grup moshës rezulton se janë në grup moshën 20-29 vjeç (2 raste) dhe grup moshën 0-9 vjeç, 10-19 vjeç, 30-39 vjeç dhe 50-59 vjeç (nga 1 rast); prej këtyre rasteve rezulton se i takojnë gjinisë mashkullore 4 raste (67%) dhe gjinisë femërore 2 raste (33%).

Gjatë vitit 2024 u raportuan 3 raste të Leptospirozës (Inc 0.16/100,000). Ky numër i rasteve është më i ulët për 40% krahasuar me vitin 2023 me 5 raste (Inc 0.28/100,000 banorë). Sipas numrit në komuna rezulton se rastet janë paraqitur si në vijim: Prishtina (2 raste) dhe Ferizaj (1 rast). Sipas grup moshës rezulton se janë në grup moshën 20-29 vjeç (1 rast), 30-39 vjeç (1 rast), 60-69 vjeç (1 rast); prej këtyre rasteve rezulton se i takojnë gjinisë mashkullore 2 raste (66%) dhe gjinisë femërore 1 rast (34%).

Sëmundja e Legjionarëve dhe ELDSNet

Gjatë vitit 2024 u raportuan 2 raste humane me sëmundjen e Legjionarëve (Inc 0.11/100,000) krahasuar me vitin 2023 gjatë cilit nuk kishte raste të raportuara të sëmundjes së Legjionarëve.

Sa i përket komunave: Prishtina (1 rast) dhe Fushë Kosova (1 rast). Rastet i takojnë grup moshës 50-59 vjeç dhe 60-69 vjeç (nga 1 rast), ndërkaq të dy rastet i takojnë gjinisë mashkullore. Nga rastet e lartpërmendura vetëm 1 rast raporton histori të udhëtimit jashtë vendit dhe qëndrim në resorte hotelerike.

ELDSNet (European Legionnaires' Disease Surveillance Network - Rrjeti i Mbikëqyrjes së Sëmundjeve të Legjionarëve në Evropë) gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 ka raportuar për 3 raste shtetas të huaj (1 rast gjatë muajit janar, 1 rast gjatë muajit prill si dhe rasti i tretë gjatë muaji korrik) të cilët janë diagnostikuar me sëmundjen e legjionarëve pas qëndrimit në Kosovë dhe disa shtete të tjera.

Nga hulumtimi epidemiologjik në terren vetëm tek rasti i tretë kemi gjetur lidhshmëri epidemiologjike në resortin ku qëndroi personi me sëmundjen e legjionarëve, ku është izoluar *Legionella pneumophila* në ujin e pishinës brenda resortit hotelerik.

Masat e kontrollit: Hulumtimi epidemiologjik, inspektimi i sistemit të furnizimit me ujë dhe sistemit të ajrit të kondicionuar (lagështia/ftohja); Matja e sasisë së klorit (në ujin e pishinës, rezervuarin e ujit të pijshëm, në rezervuarin e furnizimit me ujë të nxehtë); Është informuar menaxhmenti i hotelit për sëmundjen e Legjionarëve dhe mënyrat e përhapjes; Menaxhmentit të hotelit i shpërndahen kopje në gjuhën shqipe të fletushkës së ECDC-së "Informacion rreth sëmundjes së Legjionarëve për menaxherët e akomodimit turistik"; Nga punonjësit është kërkuar që të lajmërojnë sa më shpejt qendrat mjekësore nëse shfaqen simptoma të sëmundjes; Është kërkuar nga Departamenti i Sëmundjeve Infektive dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare që në rast të shfaqjes së rasteve të pneumonisë të lajmërohen menjëherë në formë individuale; Janë marrë mostra uji për testimin e Legionellës.


Rekomandimet: është rekomanduar të mos përdoret pishina derisa rezultatet e radhës të jenë negative për *Legionella pneumophila*. Është rekomanduar që uji në pishinë, xhakuzi/sauna; uji i shpërndarë në dhoma, banja/tualete dhe kuzhina të dezinfektohet në mënyrë të rregullt me klor ose me metoda të tjetëra adekuata të dezinfektimit.

Sëmundjet që përhapen me ujë dhe ushqim

Sëmundjet që përhapen me ujë dhe ushqim të raportuara gjatë vitit 2024 në Kosovë, në bazë të diagnozës në numër më të lartë janë: diarretë akute (108,077 raste), intoksikimet alimentare (1,102 raste) dhe gastroenterokolitet (764 raste). Nëse krahasohen me të njëjtat diagnoza gjatë vitit 2023 (diarretë akute 82,884 raste, intoksikimet alimentare 939 raste, gastroenterokolitet 398 raste) vërehet rritje e rasteve të diarresë akute për 30 %, rritje të rasteve të intoksikimeve alimentare për 17% dhe rritje të rasteve të gastroenterokoliteve për 92%.


Numri më i lartë i sëmundjeve që barten me ujë dhe ushqim u raportua në komunat: Prishtinë (28,017 raste), Prizren (11,814 raste) dhe Pejë (8,493 raste). Ndërsa incidenca më e lartë u raportua në komunat: Prishtinë (14,086 raste /100,000 banorë), Obiliq (13,221 raste /100,000 banorë) dhe Mitrovicë (10,814 raste /100,000 banorë) (Graf.14).

Grafikoni 14. Rastet e sëmundjeve që barten me ujë dhe ushqim dhe Incidenca në 100,000 banorë sipas komunave, në periudhën kohore janar - dhjetor 2024.



Nga mostrat humane të testuara në Laboratorin e Mikrobiologjisë (IKShPK) dhe Laboratorin e Mikrobiologjisë Klinike (SHSKUK) patogjenët më të detektuar janë: Rotavirus 93 izolate (38%), Salmonella enteritidis 46 izolate (19%), Giardia lamblia 30 izolate (12%), Adenovirus 21 izolate (8.7%), Clostridium difficile 19 izolate (7.8%), Enterovirus 16 izolate (6.6%), Echinococcus 5 izolate (2.0%) Escherichia Coli 4 izolate (1.7%), Norovirus 3 izolate (1.2%), virusi i Hepatitit A (HAV) dhe Entamoeba histolytica me nga 2 izolate secili patogjen (nga 0.8%). Në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 (76 izolate) vërehet se patogjeni Rotavirusi është detektuar për 27% më shumë. Ndërsa patogjeni Salmonella enteritidis në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 (46 izolate) ka rënie të izolateve për 40%. Në vitin 2024 detektimi i izolateve Giardia lamblia shënon rënie për 35% krahasuar me vitin 2023 (46 izolate). (Graf 15).


Grafikoni 15. Rastet e konfirmuara në laboratorin e Mikrobiologjisë, në periudhën kohore janar -dhjetor 2024



Sëmundjet vaksinëparandaluese

Nga ky grup i sëmundjeve gjatë vitit 2024 janë raportuar 209 raste me Pertussis nga gjithsej 736 raste të testuara nga laboratorin mikrobiologjik i IKSHPK-së si raste të dyshimta apo të mindshme me Pertussis. Rastet e konfirmuara me pertussis sipas komunave janë: Prishtinë (86 raste), Podujevë (14 raste), Drenas (5 raste), Lipjan (9 raste), Obiliq (4 raste), Prizren (1 rast), Malishevë (2 raste), Suharekë (2 rast), Ferizaj (6 raste), Shtime (3 raste), Pejë (16 raste), Deçan (10 raste), Istog (5 raste), Klinë (8 raste), Gjakovë (2 raste), Gjiilan (6 raste), Kamenicë (1 rast), Viti (2 rast), Mitrovicë (6 raste), Vushtri (5 raste), Skënderaj (5 raste) dhe Fushë Kosovë (11 raste). (Graf 16 dhe 17).


Grafikoni 16. Numri i rasteve me pertussis, Incidenca/100,00 banorë sipas komunave janar-dhjetor 2024



Grafikoni 17. Numri i rasteve të testuara dhe rastet pozitive me pertusis gjatë vitit 2024



Sipas grup-moshës: 0-1 vjeç (4 raste), 1-4 vjeç (51 raste) dhe 5-9 vjeç (46 raste), 9-18 vjeç (72 raste) dhe mbi 18 vjeç (36 raste).

Grafikoni 18. Numri i rasteve me pertussis sipas grup-moshave, janar-dhjetor 2024

Sipas gjinisë 110 raste (52.6%) me pertussis i takojnë gjinisë femërore dhe 99 raste (47.3%) me pertussis i takojnë gjinisë mashkullore.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 janë raportuar 209 raste të konfirmuara pozitive me Pertussis (Incidenca 11.72/100,000 banorë) dhe krahasur me periudhën e njëjtë të vitit 2023 me vetëm 2 raste, vërehet një rritje e konsiderueshme e numrit të rasteve. Gjatë kësaj periudhe kohore, gjithashtu edhe shtetet e rajonit janë ballafaqur me rritje të numrit të rasteve të raportuara me Pertussis.

Me Parotit gjatë vitit 2024 janë raportuar gjithsej 32 raste, numer ky që është përafërsisht i njëjtë me periudhën e njëjtë të vitit 2023, ku kanë qenë gjithsej 30 raste të raportuara.

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 është raportuar një rast i Morbillit, i importuar nga Arabia Saudite (fëmijë i moshës 2 vjeqare dhe i pavaksinuar). Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, gjithashtu i raportuar një rast me Morbill, i importuar nga Arabia Saudite.

4. HIV/AIDS dhe Infeksionet seksualisht transmissive në Kosovë, 2024

Kosova është ndër vendet me prevalencën më të ulët të HIV-it, në mesin e popullatës së përgjithshme <1% dhe të popullatës kyçe <5% (meshkujt që bëjnë seks me meshkuj (MSM), personat që injektojnë drogë (PID) dhe punonjëset femra të seksit (PFS).

Përmes hulumtimit “Mbikëqyrja e integruar biologjike dhe e sjelljeve tek popullata kyçe në Kosovë, 2024” nuk u zbulua asnjë rast me HIV në mesin e personave që injektojnë droga (PID) dhe as në mesin e punëtorëve të seksit komercial (PFS), përderisa në mesin e popullatës kyçe MSM janë konfirmuar tri raste me HIV infektion dhe prevalenca e HIV tek kjo popullatë është 0.61%.

Të dhënat ekzistuese dëshmojnë se ne nuk kemi epidemi të gjeneralizuar apo të përqendruar të HIV infeksionit.


Mbikëqyrja e HIV/AIDS/IST ne Kosovë kërkon një monitorim dhe bashkëpunim të të gjitha njësive raportuese të sektorit shëndetësor publik dhe privat, pastaj te OJQ-ve të cilat zhvillojnë programe dhe aktivitete për HIV/AIDS, përkrahje të vendimmarrësve, mbështetje financiare, ngritje te kapaciteteve te resurseve humane dhe njëkohësisht mbikëqyrje të plotë të popullatës së përgjithshme dhe atyre ne rrezik te lartë (mbikëqyrje te sjelljeve).

Të gjitha rastet e HIV, AIDS dhe Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme, gjatë vitit 2024 janë raportuar përmes fletave (forma manuale e raportimit), asnjë rast nuk është raportuar përmes SMSN.

Ecuria e HIV/AIDS gjatë vitit 2024 në Kosovë


Nga viti 1986 - 2024 janë raportuar gjithsej 215 raste me HIV dhe AIDS me 52 kanë vdekur si pasojë e AIDS-it. (Graf.19)

Grafikoni 19. Rastet HIV dhe AIDS në Kosovë, 1986-2024




Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas gjinisë, numri më i madh i takon gjinisë mashkullore (81%).(Graf.20)

Grafikoni 20. HIV dhe AIDS në Kosovë, sipas gjinisë 1986,2024




Grup mosha më e atakuar është 25-34 vjeç (35%) dhe 35-44 vjeç me 24%. (Graf.21.)

Grafikoni 21. Rastet HIV dhe AIDS sipas grup-moshës, 1986-2024




Transmisioni i HIV infeksionit përmes rrugëve të përhapjes: Rruga heteroseksuale 51% (110 rast), MSM 32% (68 raste), e panjohur 15% (33 raste), transmision vertikal 1% (2 raste) dhe PDI 1% (2raste). (Graf.22.)

Grafikoni 22. Rrugët e përhapjes së HIV infeksionit në Kosovë, 1986-2024



Numri më i madh i vdekjeve të raportuara sipas grup moshave është 25-34 vjeç (18 raste), pastaj grup mosha 35-44 vjeç (16 raste), etj. (Graf.23.)

Grafikoni 23. Vdekjet sipas grup-moshave, si pasojë e AIDS, 1986-2024



Gjatë vitit 2024 janë raportuar 34 rast me HIV dhe AIDS, 10 raste janë me AIDS, 24 me HIV infeksion. Tri raste janë të gjinisë femërore dhe 31 raste i takojnë gjinisë mashkullore.

Gjatë këtij viti 2024, është raportuar një rast i vdekjes si pasojë e AIDS-it. Rasti i takon gjinisë mashkullore, grup moshë 35-44 vjeç, nga komuna e Pejës, rruga e transmissioinit heteroseksuale.


Në grup moshën 16-24 vjeç janë 5 raste, 25-34 janë 15 raste, në grup moshën 35-44 vjeç janë 8 raste, 45-54 vjeç është 4 raste dhe po ashtu mbi 50 vjeç janë 2 raste.

Nga gjithsej 34 raste të raportuar, 19 raste (56%) rrugën e transmissioinit e kanë heteroseksual, 15 raste (44%) i përkasin popullatës kyçe MSM.

Ecuria e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme (IST) gjatë vitit 2024

Gjatë vitit 2024 janë raportuar gjithsej 400 raste të Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme. Krahësuar me vitin paraprak 2023 (480 raste të raportuara), këtë vit kemi numër më të vogël të raportimit të rasteve me IST. Rastet e raportuara të IST-ve janë nga 23 komuna (Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Deçan, Istog, Podujevë, Malishevë, Mitrovicë, Skenderaj, Vushtrri, Lipjan, F.Kosovë, Drenas, Prizren (Graf. 24). Numri më i madh i rasteve të IST-ve është nga komuna e Ferizaj 86, Pejë 137, Prishtinë 83, Prizren 16, Fushë Kosovë 11, ndërsa nga komunat tjera është raportuar numër më i vogël i rasteve.

Grafikoni 24. Rastet e Infeksioneve seksualisht të transmetueshme, sipas komunave, janar-dhjetor 2024



Rastet e IST-ve analizuar sipas diagnozave, viti 2024

Analizuar sipas diagnozave gjatë vitit 2024 numri më i madh i rasteve të raportuara është me Chlamydia 193, Condyloma ano-gjenitale 168, , Gonorrhea 28 etj. (tabela 1).

Tabela 9. Rastet e IST-ve analizuar sipas diagnozave, janar-dhjetor 2024

Diagnoza	Nr. i rasteve
Condyloma acuminata	168
Chlamydia trachomatis	193
Neisseria gonorrhoeae	28
Genital herpes	5
Ballanitis	2
Syphilis	4
Gjithsej	400

Rastet e IST-ve sipas grup moshës dhe gjinisë

Numri më i madh i rasteve të raportuara të IST-ve i takon grup moshës 25-49 vjeç me 283 raste (71%), pastaj kemi grup moshën 15-24 vjeç me 87 raste (19%). (Graf. 25)

Grafikoni 25. Rastet e IST-ve sipas grup-moshës dhe gjinisë, janar-dhjetor 2024



Rastet e Infeksioneve Seksualisht të Transmetueshme gjatë vitit 2024, Kosovë (sipas diagnozave dhe komunave)


Në tabelën 10 është paraqitur ecuria e rasteve të IST-ve sipas diagnozave dhe komunave gjatë vitit 2024. Numri më i madh i rasteve është nga komuna Pejë 137 raste (101 Chlamydia dhe 23 Gonorrhea, 10 Condyloma anogenitale, 2 Sifilis etj), komuna Ferizaj 86 raste (79 Chlamydia, 6 Condyloma dhe 1 Herpes gjenital), komuna Prishtinës 83 raste (75 Condyloma anogenitale, 3 raste Gonorrheae, etj), komunat e tjera kanë numër më të vogël të rasteve të regjistruara.

Tabela 10. Rastet e IST-ve sipas diagnozave dhe komunave, janar-dhjetor 2024.

Komunat	Diagnoza						Total
	Anogenital Condyloma	Chlamydia	Gonorrhoea	Genital herpes	Syphilis	Ballanitis	
Prishtinë	75	3	3		1	1	83
Gjakovë	1	1					2
Pejë	10	101	23	1	2		137
Klinë	2						2
Deçan		2	1				3
Podujevë	9						9
Shtime	1	1					2
Malishevë	1						1
Mitrovicë	3		1				4
Skënderaj	5						5
Vushtrri	3					1	4
Gjilan	2				1		3
Lipjan	15	1					16
Viti	1	1					2
F.Kosovë	10			1			11
Drenas	2			1			3
Kaqanik		2					2
Prizren	16						16
Rahovec	1						1
Suharekë	3						3
Ferizaj	6	79		1			86
H.Elezit		2					2
Obiliq	2			1			3
Gjithsej	168	193	28	5	4	2	400

Rastet e IST-ve sipas gjinisë, 2024

Gjatë kësaj periudhe 249 (62%) rasteve të raportuara i takojnë gjinisë femërore, ndërsa 151 (38%) i përkasin gjinisë mashkullore (grafikoni 3).

Grafikoni 26. Rastet e IST-ve sipas gjinisë, janar-dhjetor 2024**Rastet e IST-ve sipas gjinisë dhe diagnozës**

Analizuar sipas gjinisë dhe diagnozës, gjatë vitit 2024, numri më i madh i rasteve të raportuara (188) i takon gjinisë femërore me shkaktarin Chlamydia trachomatis, 41 raste me Condyloma acuminata, 18 raste me Neisseria gonorrhoeae, kurse sa i përket gjinisë mashkullore numri më të madh i rasteve është me Condyloma acuminata 127, Gonorrhoea 10, etj. (Tabela 11.)

Tabela 11. Rastet e IST-ve sipas gjinisë dhe diagnozës

Diagnoza	M	F	Total
Condyloma acuminata	127	41	168
Chlamydia trachomatis	5	188	193
Neisseria gonorrhoeae	10	18	28
Genital herpes	3	2	5
Ballanitis	2	0	2
Syphilis	4	0	4
Gjithsej	151	249	400

Ecuria e Hepatitit akut B, janar-dhjetor 2024

Gjatë kësaj periudhe kohore, në Kosovë janë raportuar gjithësej 40 raste me Hepatit akut B me Incidencë prej 2.24/100.000 banorë. Ky numër është përafësisht i njëjtë krahasuar me vitin 2023 (37 raste me Incidencë 2.1/100.000 banorë).


Sipas komunave rezulton se numri më i madh i rasteve të raportuara është nga komuna e Mitrovicës (6 raste), Gjilan (4 raste), Prishtina, Fushë Kosova dhe Gjakova me nga (3 raste), Prizreni, Ferizaj, Podujeva, Skenderaj, Hani i Elezit dhe Suhareka me nga (2 raste) dhe me nga 1 rast komunat: Pejë, Kaçanik, Lipjan, Malishevë, Obiliq, Viti, Rahovec, Drenas dhe Vushtrri.

Incidenca më e lartë e rasteve është raportuar nga komuna e Hanit të Elezit me 21/100.000 banorë, komuna e Fushë Kosovës me nga 9/100.000 banorë, Mitrovica me 8/100.000 banorë, kurse komunat tjera me Incidencë më të ulët (Graf.27)

Rastet e vdekjes me Hepatit B në Kosovë, 2024

Gjatë këtij viti janë raportuar 5 raste të vdekjes, prej tyre 2 raste me Hepatitis chr B me dg.përcjellëse (Pejë dhe Gjakovë) dhe 3 raste me Hepatitis fulminans me dg.përcjellëse (prej tyre me nga 1 rast komunat: Prishtinë, Gjilan dhe Podujevë).

Grafikoni 27. Numri i rasteve, Incidenca dhe Vdekjet/100,000 banorë me Hepatit akut B, janar - dhjetor, 2024




Ecuria e sëmundjes sipas gjinisë

Gjatë kësaj periudhe me Hepatit akut B, sipas gjinisë rezulton se kemi 75% apo (25 raste) të gjinisë mashkullore dhe të gjinisë femërore 25% apo (12 raste)

Ecuria e sëmundjes sipas grup moshave

Sa i perket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se numri më i madh i rasteve i takon grup- moshës 60-69 vjeç me nga 27.5% (11 raste), grup mosha 40-49 vjeç me 22.5% (9 raste), grup mosha 30-39 vjeç me 15% (6 raste), grup mosha 50-59 vjeç me 12.5% (5 raste), grup mosha 20-29 vjeç me 10% (4 raste), grup moshat 70-79 vjeç me 7.5% (3 raste), grup mosha 0-9 vjeç dhe mbi 80 vjeç me nga (1 rast) apo 5%, kurse grup mosha 10-19 vjeç me asnjë rast të raportuar. Incidenca specifike më e lartë i takon grup-moshës 60-69 vjeç me 8/100.000 banorë. (Graf. 28).

Grafikoni 28. Rastet dhe Incidenca specifike për grup-moshë, janar-dhjetor, 2024




Ecuria e Hepatit akut C në Kosovë, janar-dhjetor 2024

Gjatë periudhës kohore, në Kosovë janë raportuar gjithësej 3 raste me Hepatit akut C me Incidencë prej 0.16/100.000 banorë. Krahasuar me vitin 2023 kemi përafësisht numër të njëjtë të rasteve me Hepatit akut C (4 raste) me Incidencë prej 0.22/100.000 banorë.

Sipas komunave rezulton se numër më i madh i rasteve të raportuara është nga komuna e Mitrovicës (2 raste), kurse komuna e Prizrenit me 1 rast. Incidenca më e lartë e rasteve është raportuar nga komuna e Vushtrrisë me 3/100.000 banorë. (Graf.29). Gjatë këtij viti nuk ka pasur asnjë rast të vdekjes të raportuar me Hepatit akut C.

Grafikoni 29. Numri i rasteve, Incidenca dhe Vdekjet/100,000 banorë me Hepatit akut C, janar - dhjetor, 2024




Ecuria e sëmundjes sipas gjinisë

Gjatë kësaj periudhe me Hepatit akut C, sipas gjinisë rezulton se kemi 67% apo (2 raste) të gjinisë mashkullore dhe të gjinisë femërore 33% apo (1 rast)

Ecuria e sëmundjes sipas grup moshave

Sa i perket grup- moshës, gjatë kësaj periudhe, rezulton se rastet i takojnë grup moshave 20-29 vjeç, 50-59 vjeç dhe 60-69 vjeç me nga 33.3% (me nga 1 rast), kurse grup moshat tjera me asnjë rast të raportuar. Incidenca specifike më e lartë i takon grup-moshës 60-69 vjeç me 1/100.000 banorë. (Graf. 30)

Grafikoni 30. Numri i rasteve dhe Incidenca specifike për grup-moshë, janar-dhjetor, 2024



5. Vaksinimi në Kosovë

Programi i zgjeruar i imunizimit (PZI) konsiderohet si proces i suksesshëm në kuadër të fushës së shëndetit publik në Kosovë. Një nga prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) është edhe zbatimi i PZI me qëllim të parandalimit të sëmundjeve ngjitëse vaksinë parandaluese duke synuar përfshirjen e plotë të të gjitha komuniteteve të cilat jetojnë në Republikën e Kosovës.

Ministria e Shëndetësisë (MSh) siguron qëndrueshmëri financiare për PZI përmes sigurimit të vaksinave. Në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) si mbikëqyrës i zbatimit të programit dhe Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH) si institucione zbatuese, është siguruar qëndrueshmëria e këtij programi, në përgjithësi. Qendrat Rajonale të Shëndetësisë Publike (QRShP) janë përgjegjëse për analizën e të dhënave të grumbulluara dhe monitorimin e performancës së imunizimit dhe raportimin e tyre.

Viti 2024 ka qenë mjaft sfidues sa i përket PZI me përfshirjen e tri vaksinave të reja në Kalendarin e rregullt të vaksinimit (vaksina kundër rotavirusit, pneumokokut, HPV). Implementimi i suksesshëm i këtyre tri vaksinave në kalendar të rregullt ka kërkuar përpjekje të koordinuara dhe angazhim maksimal institucional.

Të gjitha aktivitetet janë realizuar sipas Planit të Veprimit për Vaksinim 2023-2026 dhe janë të lidhura me rritjen e mbulueshmërisë së vaksinimit dhe ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve, vlerësimeve dhe fushatave të ndryshme, duke përfshirë vaksinimin kundër HPV të vajzat në komunitetet vulnerabile.

Gjithashtu, është përditësuar dhe shpërndarë planprogrami i vaksinimit për profesionistët shëndetësorë në institucione shëndetësore të KPSH.

Aktivitetet e realizuara


Sa i përket ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore, mbi 550 mjekë dhe 1,664 infermierë janë trajnuar për ofrimin e shërbimeve të vaksinimit. Aktivitetet e mbikëqyrjes kanë përfshirë vaksinimin plotësues dhe fushata "derë me derë" për identifikimin dhe vaksinimin e fëmijëve të pavaksinuar, veçanërisht në komunitetet vulnerabile, Rom, Ashkali dhe Egjiptian.

Janë realizuar 350 sesione informuese për vaksinimin kundër HPV me prindërit dhe mësimdhënësit në shkolla nga të gjitha komunat. Gjithashtu, janë realizuar takime periodike me ekipet e vaksinimit për koordinimin dhe monitorimin e programit të vaksinimit në nivel vendi.

Me rekomandim nga Komiteti Profesional Këshillues për Imunizim (KPKI) dhe aprovim nga Ministri i Shëndetësisë këtë vit do të fillohet me vaksinimin e djemve me vaksinën kundër HPV.

Grafikoni 31. Mbulueshmëria me vaksinimin sipas Kalendarit të rregullt në nivel vendi, 2024

Mbulueshmëria me vaksinim 2024



Në grafikonin 31. është paraqitur mbulueshmëria sipas llojit të vaksinës në kalendarin e rregullt të vaksinimit. Sipas analizës vërehet variacion në mbulueshmëri, sa i përket grupit të vaksinave që administrohen nga 0 deri në 11 muaj. Mbulueshmëria është mjaft e lartë për dozën e parë dhe dytë mbi 90% e pasuar me dozën e tretë 80%, përfshirë edhe vaksinat e reja si ajo kundër rotavirusit dhe pneumokokut.

Sfidë mbetet mbulueshmëria e ulët me vaksinën kundër fruthit, rubellës, parotitit (MMR), marrë parasysh situatën epidemiologjike me fruth në vend, rajon dhe botë.

Ndërsa sa i përket vaksinimit të fëmijëve në klasën e parë, mbulueshmëria me dozën e dytë të vaksinës MMR dhe rivaksinimi kundër difterisë, tetanusit, poliomielitit është 94%, ndërsa klasa e gjashtë 88% e rivaksinimit të tretë kundër difterisë, tetanusit, poliomielitit.

Një sukses i jashtzakonshëm është vaksinimi i vajzave të klasëve të gjashta me vaksinën kundër HPV, ku në vitin e parë është arritur mbulueshmëria prej 85%.

Vaksinimi kundër gripit sezonal

Bazuar në planifikimet e IKShPK-së, MSh për sezonën e gripit 2024/2025 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës kundër gripit sezonal, prej të cilave përmes Sistemit të menaxhimit të stokut farmaceutik (SMSF) janë shpërndarë në të gjitha Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) të cilat më tutje kanë bërë shpërndarjen e vaksinave në njësitë e tyre vartëse ku ofrohen shërbimet e vaksinimit (Qendra të Mjekësisë Familjare/QMF dhe Ambulantat e Mjekësisë familjare / AMF).

Nga data 9 tetor deri me 31 dhjetor 2023 janë administruar gjithsej 64,011 doza të vaksinës kundër gripit sezonal në nivel vendi. Sa i përket grupeve të rrezikut, mbulueshmëria më e lartë me vaksinim i përket qytetarëve mbi 65 vjeç me 42,844 ose 26.6%, me gjendje të caktuara shëndetësore 20,862, punëtorë shëndetësor 1,446 ose 6.0 %, gra shtatzëna 3 ose 0.01%. Vaksinimi kundër gripit sezonal është duke vazhduar në të gjitha komunat e Kosovës dhe gjatë janarit është vërejtur një rritje e kërkesës për vaksinim kundër gripit sezonal që korrespondon me rritjen e rasteve me grip.

Vaksinimi kundër tetanusit me indikacion

Gjithsej janë administruar si doza të para, 12,657, doza të dyta 1,888, dozë të treta 970 dhe dozë përforcuese 24.

Vaksinimi kundër Hepatiti B me indikacion

Gjithsej janë administruar 4,321 doza të vaksinës kundër hepB, prej tyre punëtorë shëndetësor me dozën e parë 1,002, me dozën e dytë 743, dozën e tretë 493 dhe 78 si dozë përforcuese. Kontaktet familjare me HbsAg pozitiv me dozën e parë janë vaksinuar 126, dozën e dytë 98, dozën e tretë 94 dhe dozë rikujtuese 14. Për personat me sëmundje kronike të mëlçisë janë administruar gjithsej 406 doza, persona që udhëtojnë jashtë shtetit janë administruar 626 doza, 1 dozë për një person me HIV dhe 203 doza janë administruar për personat me profesione të ndryshme.

Gjithashtu për 14 persona ka qenë indikacion marrja e Imunoglobulines kundër hepatit B.

Vaksinimi kundër Rabiesit me indikacion

Gjatë vitit 2024 me rritjen e numrit të rasteve të kafshimit të qytetarëve nga qentë endacak, është shtuar edhe kërkesa për vaksinimin kundër rabiesit. Gjithsej janë administruar 849 doza të vaksinës kundër rabiesit në nivel vendi.

Vaksinimi kundër Meningjitit

Gjatë vitit 2024 janë vaksinuar 2060 qytetarë, përfshirë pelegrinët e Haxhit dhe Umrës.

Vaksinimi sipas trafikut ndërkombëtar

Sa i përket vaksinimit sipas trafikut ndërkombëtar janë mbuluar 100% kërkesat e qytetarëve tek të cilët indikohet ky vaksinim për grupe ose individë të caktuar që udhëtojnë në vendet endemo-epidemike për sëmundje të caktuara.

Gjithashtu, të gjithë qytetaret që vaksinohen pajisen me certifikatë ndërkombëtare të vaksinimit në IKShPK.

6. Situata epidemiologjike me COVID-19

Situata epidemiologjike globale


Rastet globale: Sipas të dhënave të fundit të OBSH që nga 31 dhjetor 2019 deri 31 dhjetor 2024, janë raportuar gjithsej 777,074,803 raste të COVID-19 dhe 7,079,142 raste të vdekjes dhe janë administruar 13.64 miliard doza të vaksinës kundër COVID-19.

Situata epidemiologjike në Kosovë nga fillimi i pandemisë

Nga data 08.02.2020 deri më 31.12.2024, u testuan gjithsej 2,004,191 teste të rasteve të dyshimta në virusin SARS-CoV-2.

Me SARS-CoV-2, janë diagnostikuar gjithsej 276,174 raste ose 13.77% e mostrave të testuara. Deri më 31.12.2024, janë shëruar 272,940 raste ose 98.82% e të infektuarve, dhe gjatë kësaj periudhe është regjistruar 1 rast aktiv. Deri më 31.12.2024, janë regjistruar gjithsej 3,233 raste të vdekjeve me një shkallë të letalitetit prej 1.17%.

Grafikoni 32. Rastet e konfirmuara, shëruara dhe vdekjet nga COVID-19 në Kosovë, 2020-2024



Situata epidemiologjike me COVID-19, janar-dhjetor 2024


Gjatë vitit 2024 (01.01.2024-31.12.2024) nga 8,736 mostra të testuara te personat e dyshimtë në virusin SARS-CoV-2, u konfirmuan 1,735 raste pozitive dhe u raportuan 11 raste të vdekjes nga COVID-19 me CFR=0.63%. Sipas grup-moshave rezulton se numri më i madh i rasteve i takojnë grup-moshës 50-59 vjeç (me 309 raste).

Grafikoni 33. Numri i rasteve të dyshimta dhe rastet COVID-19, janar-dhjetor 2024




Gjatë vitit 2024 prej rasteve të konfirmuara me COVID-19, sipas komunave rezulton se numri më i madh i rasteve është raportuar nga komuna e Prishtinës (1,087 raste), e Gjilanit (173 raste) dhe e Gjakovës (141 raste) kurse incidenca më e lartë e rasteve në 100,000 banorë (morbidity) është raportuar nga komunat e Prishtinës, e Gjilanit dhe Gjakovës. Sa i përket rasteve të vdekjes numri më i madh është raportuar nga komuna e Prishtinës dhe Vushtrrisë me nga 2 raste.

Grafikoni 34. Numri i rasteve me COVID-19, Incidenca sipas komunave janar-dhjetor 2024



Gjatë vitit 2024 prej rasteve të konfirmuara me COVID-19, sipas grup-moshave rezulton se numri më i madh i rasteve i takojnë grup-moshave 40-49 (270 raste) dhe 50-59 (311 raste) kurse numri më i vogël i rasteve i takon grup-moshës 80+ vjeç me 55 raste. Sipas incidencës specifike për grup-moshë, rezulton se grup-mosha më e prekur është ajo 70-79 vjeç nga 189 raste/100,000 banorë). Mosha mesatare e rasteve të konfirmuara gjatë vitit ishte 47.34 vjeç.

Grafikoni 35. Rastet dhe Incidenca specifike për grup-moshë në Kosovë gjatë vitit 2024



Gjatë vitit 2024, prej rasteve të konfirmuara me COVID-19, sipas gjinisë rezulton se gjinia femërore prezenton me 42% (726 raste) sikurse edhe ajo mashkullore me 58% (1,009 raste)

Krahasimi i situatës epidemiologjike me COVID-19 gjatë viteve 2023 dhe 2024

Gjatë periudhës së vitit 2023 (01.01.2023 – 31.12.2023) në Kosovë janë raportuar 2,153 raste (mesatarja 5.89 raste pozitive), Mb= 120.81/100.000 banorë, me pozitivitet mesatar prej 0.12% dhe 20 raste të vdekjes me CFR=0.92%.

Gjatë periudhës së vitit 2024 (01.01.2024 – 31.12.2024) në Kosovë janë raportuar 1,735 raste (mesatarja 4.74 raste pozitive), Mb= 97.35/100.000 banorë, me pozitivitet mesatar prej 8.22% dhe 11 raste të vdekjes me CFR=0.63%.

Nëse krahasojmë këto periudha dy vjetore kemi rënie të numrit të rasteve pozitive për 19.45%, rritje të shkallës së pozitivitetit si dhe rënie të rasteve të vdekjes prej 45%.

Sekuencionimi gjenetik dhe përcaktimi i varianteve qarkulluese të SARS-CoV-2

Në Departamentin e Mikrobiologjisë, IKSHPK, Prishtinë, janë sekuencuar me sukses dhe analizuar në total 83 mostra me SARS-CoV-2 të mbledhura nga rastet pozitive në SARS CoV-2 në Kosovë nga periudha 10 korrik – 09 gusht 2024, përkatësisht nga java njëzet e tetë (28) - java tridhjetë e dy (32) e vitit 2024.

Klasifikimi i varianteve shërben si një mjet i rëndësishëm komunikimi, për të paralajmëruar vendet për shfaqjen e varianteve të SARS-CoV-2 me veçori shqetësuese, e që mund të ndikojnë në situatën epidemiologjike. Edhe në laboratorin tone, përcjellja e situatës epidemiologjike me COVID-19 është orientuar drejt sekuencionimit dhe hulumtimit të varianteve eventuale të reja në qarkullim.

SARS-CoV-2 ishte 10% krahasuar me 10% në javën 47/2024. Norma mesatare e pozitivitetit për 18 vende dhe zona ishte 8% (varg: 0%-24%). Në të gjithë rajonin, përqindja e të gjithë mostrave nga pacientët që paraqiteshin në qendrat e SARI-s sentinel që rezultuan pozitivë për SARS-CoV-2 ishte 13% krahasuar me 14% në javën e 47/2024.

Midis javëve 48/2024 dhe 49/2024, 10 vende dhe zona raportuan informacion mjaft të plotë për të lejuar llogaritjen e frekuencës relative të varianteve specifike. Midis këtyre vendeve dhe zonave, përqindja mesatare (gama) e të gjitha izolimeve të sekuencave të virusit të zbuluara, që janë një variant aktual ose i mëparshëm shqetësimi ose variant interesi, ishte:

- PK.3: 41% (18%-79% nga 10 vende dhe zona).
- BA.2.86: 14% (6=0%-82% nga 7 vende dhe zona). Shënim: Izolat JN.1 përfshihen në BA.2.86.
- Variantet më të zakonshme SARS-CoV-2 në GISAID për Rajonin Evropian në tetor deri më tani ishin: KP.3.1.1 (28%); XEC (50%); KP.3.1 (2%); JN.1 (5%); JN.1.11 (4%); dhe JN.1 (5%) (n=195).

Në Kosovë varianti i SARS-CoV-2 Omicron BA.2.86 dhe subvariantet e tij, përfshirë KP.3, dominonin në mesin e mostrave të testuara pozitive në virusin SARS CoV-2, në periudhën një-mujore nga 10 Korrik deri 9 Gusht 2024.


- **53% për Variantin KP.3 (44 detektime)**
- **47% për Variantin BA.2.86 (39 detektime).**

Rrjedhimisht, prania e nën-linjave të variantit të Omicronit të SARS-CoV-2 në Kosovë ishte në përputhje të përafërt me epidemiologjinë virologjike të SARS-CoV-2 në vendet tjera Europiane, përkatësisht me dominim të variantit KP.3.

Për më shumë detaje, gjeni të dhënat në figurën e bashkangjitur:

Grafikoni 36. Variantet qarkulluese të SARS-CoV-2 në Kosovë, 2024

Variantet e SARS-CoV-2 në Kosovë, korrik-gusht, 2024



7. Rastet e vdekjeve nga sëmundjet ngjitëse në Kosovë, 2024

Tabela 12. Rastet e vdekjeve të raportuara në Kosovë, sipas diagnozave klinike

Diagnoza	Numri i rasteve të vdekjeve të raportuara
<i>Meningoencephalitis ac. (me diagnozë përcjellëse)</i>	10
<i>Meningoencephalitis ac. Purulenta</i>	2
<i>Meningitis ac.</i>	3
<i>Meningitis meningococcica</i>	3
<i>Insufficiencia respiratore me diagnozë përcjellëse</i>	4
<i>Bronchopneumonia, me diagnozë përcjellëse</i>	45
<i>Gastroenterocolitis (me diagnozë përcjellëse)</i>	4
<i>Infiltratio pulmonum</i>	21
<i>Influenca A me diagnozë përcjellëse</i>	1
<i>Hepatitis fulminant me diagnozë përcjellëse</i>	3
<i>Hepatitis chronica B me diagnoza përcjellëse</i>	2
<i>Sy. Steven Johnson</i>	2
<i>Leptospirozë</i>	1
<i>Tuberkulozi (TB)</i>	5
<i>HIV/AIDS</i>	1
<i>EHKK</i>	1
<i>COVID-19 me diagnozë përcjellëse</i>	11
Gjithsej	119

Në periudhën janar-dhjetor 2024, numri i rasteve të vdekjeve të raportuara nga sëmundjet ngjitëse ka arritur në 117 raste, duke shënuar një rënie krahasuar me periudhën e mëparshme. Nga këto raste, numri më i lartë i vdekjeve është nga: Bronchopneumonia dhe Infiltratio pulmonum me 45 raste dhe 21 raste respektivisht 38.5% dhe 17.94% pasuar nga Meningoencephalitis ac. (me diagnozë përcjellëse) me 10 raste të vdekjes dhe COVID-19 me 9 raste të vdekjes me 8.54% respektivisht 7.7%. (shih Tabelën 12).

8. Ecuria e epidemive të lajmëruara në Kosovë gjatë vitit 2024

Gjatë periudhës kohore janar-dhjetor 2024, janë raportuar 17 epidemi, prej tyre 9 janë epidemi kolektive dhe 8 epidemi familjare. Komunat e prekura me epidemi janë komuna e Prishtinës, Ferizajit, Rahovecit dhe Pejës. Epidemitë kolektive janë raportuar me dg.Intoxicatio alimentaris, me ç'rast si shkaktarë patogjen në mostra të ushqimit dhe koprokulturë, në 30% të mostrave është izoluar Salmonella enteritidis, në 10% të mostrave është izoluar Staphylococcus aureus, ndërsa në 60% të rasteve nuk është marrë mostra ose është marrë pas përdorimit të antibiotikëve. Shkaktari i izoluar në mjetet e punës strishot e ambientit dhe duart e personelit, në 40% të mostrave është izoluar Staphylococcus aureus, me nga 30% të mostrave është izoluar Escherichia coli dhe Staphilococcus saprophyticus, kurse në 10% të mostrave është izoluar Staphilococcus albus, Staphilococcus epidermidis, Acinetobacter spp., Enterococcus spp., Enterobacter aerogenes, Klebsiella pneumoniae dhe Klebsiella spp. Epidemitë familjare (6 epidemi) janë raportuar si epidemi me dg. Brucellozis dhe 1 epidemi me Hepatitis B chr.

Gjatë vitit 2024, të ekspozuar kanë qenë 687 persona, prej tyre të sëmurë 148 raste (shkalla e sulmit 21.5%) dhe të hospitalizuar 51 raste (34.4%) (Tab.17)

Krahasuar epidemitë e lajmëruara gjatë vitit 2023, gjithsej 8 epidemi kanë qenë të raportuara, prej tyre 7 epidemi kolektive dhe 1 epidemi familjare, mirëpo, gjatë vitit 2023 ka patur numër dukshëm më të lartë të rasteve të përfshira në epidemi (të sëmurë 409 raste dhe të hospitalizuar 118 raste) krahasuar me vitin 2024

Të gjitha epidemitë janë hulumtuar dhe janë përpunuar nga stafi i IKShPK në bashkpunim me QRShP, AUV dhe Inspektorati sanitar komunal.


Tabela 13. Epidemitë e raportuara në Kosovë, periudha janar-dhjetor, 2024

Nr.	Sëmundja	Vendi	Ekspozuar	Numri i të sëmurëve	Numri i të hospitalizuarve	Shkalla e sulmit %	Data e fillimit	Data e zbulimit	Rruga e përhapjes	Shkaktari i izoluar në ushqim dhe koprokulturë	Shkaktari i izoluar në mjetet e punës, strishot e ambientit dhe duart e personelit
1	Bruceloza	Rahovec	4	2	2	50.00%	02.01.2024	04.01.2024	Kontakti	WRIGHT/ASHB Brucelosis	
2	Bruceloza	Rahovec	15	3	3	20.00%	02.02.2024	13.02.2024	Kontakti	WRIGHT/ASHB Brucelosis	
3	Intoxicatio alimentaris	Pejë	31	24	3	77.41%	16.03.2024	17.03.2024	Ushqimi	Salmonella enteritidis	Staphylococcus aureus, Acinetobacter spp. Enterobacter aerogenes
4	Intoxicatio alimentaris	Prishtinë	28	26	4	93.00%	01.04.2024	05.04.2024	Ushqimi	Salmonella enteritidis	
5	Intoxicatio alimentaris	Kaçanik	95	22	1	23.15%	15.05.2024	16.05.2024	Ushqimi	Mostra është marre pas terapisë	E.Coli
6	Intoxicatio alimentaris	Ferizaj	60	8	0	13.30%	03.07.2024	04.07.2024	Ushqimi	Nuk është marre mostra	Staphylococcus aureus, Escherichia coli dhe Enterococcus spp.
7	Intoxicatio alimentaris	Prishtinë	24	18	16	75.00%	16.08.2024	17.08.2024	Ushqimi	Staphylococcus aureus	
8	Intoxicatio alimentaris	Prishtinë	4	3	3	75.00%	15.08.2024	16.08.2024	Ushqimi		Staphylococcus albus
9	Intoxicatio alimentaris	Mitrovicë	200	10	4	5.00%	08.08.2024	12.08.2024	Ushqimi		Staphylococcus saprophyticus, Staphylococcus epidermidis, Staphylococcus aureus, Klebsiella spp., E.Coli
10	Intoxicatio alimentaris	Vushtrri	150	3	3	1.33%	11.08.2024	12.08.2024	Ushqimi		Staphylococcus saprophyticus
11	Bruceloza	Ferizaj	8	2	2	25.00%		09.08.2024	Kontakti	WRIGHT/ASHB Brucelosis	
12	Intoxicatio alimentaris	Pejë	5	3	3	100.00%	23.09.2024	28.09.2024	Ushqimi	Salmonella enterica spp.	Staphylococcus aureus dhe Klebsiella pneumoniae
13	Bruceloza	Ferizaj	12	2	2	16.66%		04.10.2024	Kontakti	Brucelosis	
14	Bruceloza	Prizren	2	2	2	100.00%	17.07.2024	19.10.2024	Kontakti	WRIGHT/ASHB Brucelosis	
15	Hepatit kronik B	Suharekë	4	2	2	50.00%	13.09.2024	01.10.2024	Kontakti		
16	Intoxicatio alimentaris	Hani Elezit	40	13	1	32.50%	21.11.2024	22.11.2024	Ushqimi		Staphylococcus saprophyticus
17	Bruceloza	Rahovec	5	5	0	100.00%	05.12.2024	10.12.2024	Kontakti	WRIGHT/ASHB Brucelosis	

Ecuria e epidemive të paraqitura në Kosovë sipas muajve, 2024


Sa i përket sezonalitetit të paraqitjes së epidemive, gjatë vitit 2024, numër më i lartë i epidemive janë paraqitur gjatë muajit gusht gjithsej 5 epidemi (3 epidemi kolektive dhe 2 epidemi familjare), gjatë muajit tetor janë paraqitur 3 epidemi familjare, kurse gjatë muajve tjerë janë raportuar nga 1 epidemi kolektive përveq muajit qershor ku na ka pasur asnjë epidemi të paraqitur. (Graf.37).

Grafikoni 37. Numri i rasteve me Intoksikim alimentar gjatë periudhës janar-dhjetor, 2024




Ecuria e epidemive në Kosovë sipas grup moshave

Sa i përket grup- moshës tek rastet e anketuara, gjatë kësaj periudhe, rezulton se grup mosha më e atakuar është 20-29 vjeç me 36.4% (54 raste), 10-19 vjeç me 22.3% (33 raste), grup mosha 30-39 vjeç me 16.2% (24 raste), grup moshat 40-49 vjeç me 14.2% (21 raste), grup moshat 50-59 vjeç me 5.4% (8 raste), grup mosha 60-69 vjeç me 2.7% (4 raste), grup moshat 0-9 vjeç me 2.02% (3 raste) grup moshat 70-79 vjeç me 0.67% (1 rast), kurse grup mosha mbi 80 vjeç me asnjë rast të raportuar. (Graf.38)

Grafikoni 38. Rastet dhe Incidenca specifike për grup-moshë, janar-dhjetor, 2024**Ecuria e epidemive të paraqitura në Kosovë sipas gjinisë, 2024**


Gjatë kësaj periudhe, sipas gjinisë rezulton se kemi 59% (88 raste) të gjinisë mashkullore dhe të gjinisë femërore 41% (60 raste). (Graf. 39).

Grafikoni 39. Epidemitë e raportuara në Kosovë, sipas gjinisë, janar-dhjetor 2024

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024, sipas komunave, rezulton se numri më i madh i rasteve është raportuar nga komuna e Prishtinës (47 raste), Peja (27 raste), Kaçaniku me (22 raste), Hani i Elezit me (13 raste),

Ferizaj me (12 raste), Mitrovicë dhe Rahovec me nga (10 raste), Vushtrri (3 raste) dhe me nga 2 raste komunat: Prizren dhe Suharekë, ndërsa Incidenca më e lartë e rasteve në 100,000 banorë është raportuar nga komuna e Hani i Elezit me 138/100,000 banorë, Kaçaniku me 66/100,000 banorë, Ferizaji me 28/100,000 banorë dhe Prishtinë me 24/100,000 banorë, kurse komunat tjera me Incidencë më të ulët të rasteve të përfshira në epidemi. Nuk ka pasur asnjë rast të vdekjes të raportuar (Graf.40)

Grafikoni 40. Numri i rasteve dhe Incidenca 100,000 banorë, janar- dhjetor 2024



Konkluzionet

Bazuar në HACCP (Analiza e rrezikut dhe pikat kritike të kontrollit), në 83% të rasteve, nuk është zbatuar kontrolli i rrezeve të sigurisë ushqimore dhe zbatimi i praktikave higjienike në të gjithë linjën e prodhimit të ushqimit. Hetimet vunë në dukje gabime të mundshme në praktikat higjienike në kontekstin e shfaqjes së higjienës joadekuate të duarve të personelit që shërbenin ushqim, menaxhimit të dobët të lavanderisë dhe higjienës joadekuate të ambientit të punës. Duke u bazuar në këto të dhëna, shkaktarët patogjen në mostra të ushqimit dhe koprokulturë, në 30% të mostrave është izoluar *Salmonella enteritidis*, në 10% të mostrave është izoluar *Staphylococcus aureus*, ndërsa në 60% të rasteve nuk është marrë mostra ose është marrë pas përdorimit të antibiotikëve. Shkaktari i izoluar në mjetet e punës strishot e ambientit dhe duart e personelit, në 40% të mostrave është izoluar *Staphylococcus aureus*, me nga 30% të mostrave është izoluar *Escherichia coli* dhe *Staphylococcus saprophyticus*, kurse në 10% të mostrave është izoluar *Staphylococcus albus*, *Staphylococcus epidermidis*, *Acinetobacter* spp., *Enterococcus* spp., *Enterobacter aerogenes*, *Klebsiella pneumoniae* dhe *Klebsiella* spp. Gjetjet laboratorike dhe epidemiologjike treguan se burimi i shpërthimit në 75% të epidemive ishte sosi i majonezës. *Salmonella Enteritidis*, shpesh e lidhur me vezë të kontaminuara, mund të jetë futur në majonezë. Zbulimi i *Staphylococcus aureus* u identifikua në shtupa të marra nga duart e mbajtësit të ushqimit kjo thekson rëndësinë e ruajtjes së higjienës personale në zonat e përgatitjes së ushqimit.

9. Rekomandimet

Për ngritjen e kualitetit të raportimit, mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe aplikimin e masave parandaluese dhe kundërepidemike me kohë rekomandojmë:

Bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200, Neni 20 dhe 21 të gjitha Institucionet shëndetësore obligohen të raportojnë në IKSHPK/QRSHIP sipas listës së sëmundjeve ngjitëse Aneksi 1 i këtij ligji.


Inspektorët shëndetësor dhe sanitar të bëjnë mbikëqyrjen e sistemit të raportimit të sëmundjeve ngjitëse, bazuar në Ligjin për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve ngjitëse Nr.08/L-200 për mënyrën e regjistrimit/raportimit të sëmundjeve ngjitëse në të gjitha Institucionet shëndetësore.

Raportimi i sëmundjeve të bëhet përmes sistemit të digjitalizuar të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse në të gjitha nivelet me qëllim të sigurimit të të dhënave dhe pasqyrës reale të situatës epidemiologjike në kohë reale për parandalim dhe kontrollë të sëmundjes.

Organizimi i trajnimeve rifreskues për epidemiologët dhe mjekët specialist të shëndetit publik lidhur me përgaditjen dhe përgjegjen epidemiologjike.

Sëmundjet zoonotike dhe ato që përcillen nga vektorët në Kosovë po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme dhe po ndryshojnë pasqyrën e ngarkesës nga sëmundjet ngjitëse, prandaj rekomandojmë bashkëpunimin ndërsektorial dhe themelimin e komitetit për shëndetin human, animal dhe mjedisor me qasjen “Një shëndet”.

Të ketë bashkëpunim të plotë në mes të IKSHPK me QKUK-Klinikën Infektive, Pediatrike, Pulmologjike, QKTGJ dhe me të gjitha nivelet tjera të cilat janë përgjegjëse për raportimin e rasteve me sëmundje ngjitëse.



INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE

Departamenti i Epidemiologjisë

***Adresa: Rr.NënaTerezë (p.n) rrethi i spitalit, Prishtinë
10000***

WebFaqe: <http://www.niph-kosova.org>

E-mail: ariana.kalveshi@rks-gov.net

Telefoni: +38338 551432, ext. 1013

Fax: +383 38 550585

